



Procesverbal i Takimit të Mekanizmit Komunal kundër Dhunës në Familje

Data: 16 Tetor 2024

Ora: 13:30

Vendi: Komuna e Deçanit

Tema e Takimit: Shqyrtimi dhe plotësimi i Draft Strategjisë Komunale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027 dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027.

Pjesëmarrës:

1. Adem Çeku – Përfaqësues i Stacionit të Policisë
2. Tringa Dreshaj – OSBE
3. Afrim Hasanmeta – Përfaqësues nga Kultura
4. Valmira Halilaj – Përfaqësuese nga Zyra e Kryetarit
5. Shaban Pejçinovic – Përfaqësues për Komunitete dhe Kthim
6. Drita Hakaj – Shërbimi Sprovues, Drejtorja Rajonale Pejë
7. Ajne Iberhysaj – Ushtruese detyre për Barazi Gjinore
8. Islam Mustafaj – Drejtor i Qendrës për Punë Sociale


Përmbledhje e diskutimeve:

Prezantimi i draft -Strategjisë dhe Planit të Veprimit

Ajne Iberhysaj, ushtruese detyre për barazi gjinore, prezantoi Draft Strategjinë Komunale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027 dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027. Ajo theksoi se hartimi i kësaj strategjie është bazuar në Vendimin për Hartimin e Strategjisë me numër protokolli 01/14451, të datës 08.05.2024. Strategjia është miratuar në leximin e parë nga Asambleja Komunale dhe është publikuar për debat publik në uebfaqen zyrtare të komunës. Ajo ftoi pjesëmarrësit të kontribuojnë në përmirësimin e këtyre dokumenteve të rëndësishme për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

Fjala e Adem Çekut – Përfaqësues i Stacionit të Policisë

Adem Çeku theksoi rëndësinë e kontributit të përbashkët për përmirësimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Ai nënvizoi se mbrojtja e viktimave, veçanërisht e fëmijëve, është një prioritet kryesor. Me numrin e rasteve të dhunës në familje në rritje, ai propozoi krijimin e një qendre të specializuar për trajtimin dhe kujdesin ndaj viktimave të dhunës, me fokus të veçantë tek fëmijët. Çeku përmendi gjithashtu se stacioni i policisë ka mbajtur sesione informuese në shkolla, duke



trajtuar tema si dhuna në familje, përdorimi i substancave narkotike, ekstremizmi i dhunshëm dhe siguria kibernetike.

Fjala e Drita Hakës – Përfaqësuese e Shërbimit Sprovues, Drejtoria Rajonale Pejë
Drita Haka theksoi se Shërbimi Sprovues i Kosovës është një Agjenci Ekzekutive që funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe është i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore. Misioni i këtij shërbimi është zbatimi i masave dhe dënimeve alternative për të promovuar rehabilitimin, reintegrimin dhe risocializimin e personave që janë dënuar me masa alternative nga organet kompetente të drejtësisë. Ajo theksoi se veprimtaria e Shërbimit Sprovues përfshin organizimin dhe mbikëqyrjen e dënimeve alternative, përgatitjen e anketave sociale dhe raporteve para-ndëshkuese, ekzekutimin e masave edukative për të mitur, si dhe mbikëqyrjen e personave të varur nga droga ose alkooli. Gjithashtu, ky shërbim ndihmon në riintegrimin dhe risocializimin e personave të liruar me kusht dhe propozon ndryshimet e nevojshme në legjislacionin përkatës.

Konkluzione:

- U nënvizua rëndësia e kontributit të të gjitha palëve për përmirësimin e Draft Strategjisë dhe Planit të Veprimit.
- U theksua nevoja për krijimin e një qendre të specializuar për trajtimin e viktimave të dhunës në familje, veçanërisht për fëmijët.
- U raportua rritja e numrit të rasteve të raportuara dhe nevoja për kujdes të shtuar.

Takimi u mbyll në orën 15:00.

Procesverbalin e mbajti

U.D për Barazi Gjinore

Ajne Iberhysaj



Foto nga takimi

